

ZANIN I NALTË-ZËDHËNËS I MENDIMIT INTELEKTUAL SHQIPTAR MYSLIMAN

Beqir MEMETI¹

¹PhD kandidat, Universiteti i Tetovës

*e-maili për korrespondencë: beqir.memeti@unite.edu.mk

Abstrakt

Revista “Zani i Naltë” u lind kur ende vazhdonin paqartësitë, kur u shfaqën një mori rrymash mes të cilave disa nxjerrnin vlera të vërteta e të guximshme për kohën. “Zani i Naltë” i shpërndau këto vlera të zgjedhura dhe të përshtatshme për psikologjinë, moralin dhe idealet e shoqërisë shqiptare. Për të zbatuar programin e shpallur, revista grumbulloi rreth vetes një staf bashkëpunëtorësh të kualifikuar, jo vetëm për problemet e çështjet fetare, por edhe për ato kombëtare. Tematika e trajtuar në këtë revistë, e konsideruar edhe tani si bashkëkohore, mund të ndahet në tri grupe: artikuj të mirëfilltë fetarë të cilët në çdo numër zinin vendin kryesor, artikuj që kultivojnë atdhedashurinë, të bazuar në fe, por të aktualizuar me gjendjen që kalonte vendi ynë në atë kohë, artikuj moralë e shoqërorë. Është e natyrshme që, si revistë fetare që ishte, të trajtonte, në radhë të parë, probleme të një spektri të gjerë, të cilat kishin lidhje me fenë në përgjithësi e me atë islame në veçanti. Pjesa letrare e revistës ka qenë një tribunë e hapur për krijuesit e ndryshëm, me krijimtarinë e tyre origjinale dhe përkthime, në prozë e në poezi.

Fjalët kyçe: Revista, mendimi fetar, mendimi intelektual, publicistika shqiptare.

Revista “Zani i Naltë” u lind kur ende vazhdonin paqartësitë, kur u shfaqën një mori rrymash mes të cilave disa nxjerrnin vlera të vërteta e të guximshme për kohën, të cilat nxitnin progresin, duke u mbështetur në vlerat më aktive të mendimit islam dhe të atij shqiptar. “Zani i Naltë” i shpërndau këto vlera të zgjedhura dhe të përshtatshme për psikologjinë, moralin dhe idealet e shoqërisë shqiptare. Kështu “Zani i Naltë” u kthye në një vend takimi, në një derë, në një fushë, në një rrugë që të çonte drejt progresit. Në fushën e veprimtarisë shoqërore “Zani i Naltë” me shumë kurajë civile hapi tribunën e debatit për koncepte e praktika vërtet të diskutueshme për shumë probleme, që koha i shtronte për zgjidhje. Kësisoj “Zani i Naltë” lexuesit i zgjeroi vizionin demokratik me joshjen drejt zhvillimeve shoqërore. Me shkrimet revista dha edhe shpresë, edhe besim, edhe siguri për brezat e ardhshëm, kur pohonte: “Mos të kujtojë brezi i ri se përparimin e njerëzisë, për mbarëvajtjen e jetës sociale brenda në kufij të moralit, nuk jemi përkrahësit e zhvillimit të gjithmbarshëm” (A. Bala (1998): 2-4; G. Skura (2013): 12-16).

Që në numrin e parë, drejtuesit e revistës vënin në dukje se, “Barra qi i kemi ngarkuem vehtes asht përnjëmend e rëndë. Duhet vullnet, energji, guxim e flije për me i arrijtun qëllimit te shejtnuem”. Në vazhdim të parathënies së numrit të parë, e të këtij qëllimi, paraqitet progresi që përmbledhet kështu: “Na nuk do t’i dalim para popullit mysliman shqiptar me një program të hijeshuem, me fjalë të bukra qi s’munden m’u realizuem.

Qe pikat kryesore të programit tonë: 1) Me bashkue me një trup të fortë e të qëndrueshëm popullin Mysliman shqiptar. 2) Me përmirësuar gjendjen e vakufëve, të xhamijave, të mesxhideve, të medreseve, të teqeve e të tjera institucioneve muslimane kësi sojit. 3) Me ia zbuluar popullit Mysliman shqiptar të vërtetat e besimit në një mënyrë të thjeshtë e të pandërlikueme, tue ia ngrofun këtij zemrën në dashni për këto të vërteta. 4) Simbas statutit me plotësue vllaznim ndërmjet të gjithë elementëve në Shqipni. 5) Me këto nijete, mandej me forcue edhe themelet e politikës së shëndoshë e thjesht kombëtare në shtetin tonë (Zani Naltë, v. I (2013): 2-3).

Për të zbatuar programin e shpallur, revista grumbulloi rreth vetes një staf bashkëpunëtorësh të kualifikuar, jo vetëm për problemet e çështjet fetare, por edhe për ato kombëtare e ndërmjet tyre mund të përmendim Hafiz Ali Korçën, Mehdi e Mit'hat Frashërin, Nebil Çikën e të tjerë dhe ky grup bashkëpunëtorësh erdhi gjithnjë duke u forcuar e freskuar, duke aktivizuar nga teologët, por edhe nga intelektualët më të përmendur të kohës. Meritë e redaksisë së kësaj reviste, duke filluar që nga drejtori i saj i parë, Ismail Maçi nga Tirana, e në vazhdim Hafiz Isa Domi nga Shkodra, Shyqyri Myftiu ga Peqini e Haki Sharofi nga Dibra, nuk është se u aktivizuan vetë për të shkruar apo përkthyer artikuj të rëndësishëm teologjikë e me përmbajtje morali atdhetar. Përkundrazi, ata pak u dalluan në këtë drejtim, por meritë, ata kanë se përcaktuan temat kryesore, që do të rriheshin në faqet e saj dhe për këto tema zgjodhën dhe u lanë dorë të lirë njerëzve nga më kompetentët e kohës, të cilët temat i trajtuan me një origjinalitet, thjeshtësi e logjikë të mahnitshme (A. Basha (2013): 7-9).

Jehona e revistës që e shpejtë. Që në numrin e dytë filloi bashkëpunimi i intelektualëve, u treguan përshtypjet, u shfaqën vlerësimet, u shpreh optimizmi për të ardhmen e saj. Revista nga numri në numër është përmirësuar nga zgjerimi i tematikës, nga shtimi i bashkëpunëtorëve, nga ngritja e cilësisë së materialeve, nga rritja e vëllimit e nga paraqitja teknike e estetike. Meritë kryesore për këtë kanë pasur drejtuesit e saj: Ismail Maçi, Shyqyri Myftia, Isa Domi e Haki Sharofi. Përmbajtja kryesore ka qenë ajo fetare, duke pasur si bosht komentin e librit të shenjtë Kur'anin, jetën e Profetit Muhamed (a.s.) dhe historinë islame. Për këto ka pasur hytbe, studime origjinale dhe përkthime (F. Luli& I. Dizdari (1998): 4).

Tematika e trajtuar në këtë revistë, mund të ndahet në tri grupe, sigurisht kjo lloj ndarjeje, megjithëse subjektive, bëhet për të parashtruar më drejt temat e trajtuara në këtë revistë: 1) Në të do të gjejmë artikuj të mirëfilltë fetarë të cilët në çdo numër zinin vendin kryesor; 2) Në revistë do të gjejmë artikuj që kultivojnë atdhedashurinë, të bazuar në fe, por të aktualizuar me gjendjen që kalonte vendi ynë në atë kohë; 3) Artikuj moralë e shoqërorë. Këta lloj artikujsh kishin lidhje me trajtimin, që u bënte feja çështjeve të moralit dhe të shoqërisë (B. Memeti (2016): 2).

Është më se e natyrshme që, si revistë fetare që ishte, të trajtonte, në radhë të parë, probleme të një spektri të gjerë, të cilat kishin lidhje me fenë në përgjithësi e me atë islame në veçanti, por sigurisht, pa lënë pas dore çështje të tjera që ishin në programin e saj (A. Basha (2013): 10).

Ndër teologët më i shquari ka qenë Hafiz Ali Korça, një nga nismëtarët e krijimit të revistës. Mjafton të vëmë në dukje se vetëm në periudhën 1923-1929 ka botuar 54 tituj, shpeshherë edhe nga 2-3 shkrime, duke arritur deri në 5 shkrime, si “*Tefsiri për suren e Kur'anit*”, “*Hytbe e Kurban Bajramit*”, poezia “*Ndryshimi i shpejtë kombëtar*”, studimi “*Muslimanizma dhe orientalizma*” dhe materiali historik “*Haxh'xhi është ma e madhja pasqyrë për demokracinë muslimane*” (F. Luli& I. Dizdari (1998): 2). Për probleme fetare kanë shkruar edhe intelektualë të tjerë fetarë si Haki Sharofi, Jonuz Bulej, Hasan Tahsini, Hafiz Xhaferri etj. Për një tematikë të gjerë problemesh, si kryeartikuj, komentim hadithesh, përkthime për personalitete nga historia e kulturës islame.

Vargut të këtyre bashkëpunëtorëve të fushave të teologjisë u bashkohen intelektualë të shquar laikë si Salih Vuçiterni, Mehdi Frashëri, Lumo Skëndo, Ferit Vokopola, Sheuqet Muka, Ihsan Qereshniku etj, që kanë qenë autorë shkrimesh me vlerë për reforma, për modernizim të medreseve, për një zhvillim kulturor islam shqiptar bashkëkohor, për interpretime të shkencave natyrore e shoqërore në bazë të parimeve filozofike, morale e etike të Kur'anit famëlartë etj. Këta intelektualë fetarë e laikë qenë në ballë të polemikave, debateve e replikave me organe shtypi, individë e grupe njerëzish që shpifnin, intrigonin e keqinterprettonin për bazat e fesë islame, për karakterin universal të islamizmit, për rolin e nivelin e shtypit Islam, për arritjet fetare, kulturore e shkencore të tij. Një vend të duhur ka zënë tema e arsimimit të fëmijëve e të rinisë. Në faqet e revistës ka pasur shkrime me karakter politik, analizues, përgjithësues e shkëmbim përvoja për organizimin e medreseve e për rezultatet e tyre, për zhvillimin e mësimin të besimit në shkollat shtetërore, për rëndësinë e edukimit të gjithanshëm të rinisë në aspektin fetar, shkencor, atdhetar, moral e kulturor (F. Luli & I. Dizdari (1998): 2-4).

Pjesa letrare e revistës ka qenë një tribunë mikpritëse për krijuesit e ndryshëm, të vjetër e të rinj të njohur e fillestarë, me krijimtarinë e tyre origjinale e në përkthime, në të dy rastet në prozë e në poezi. Janë të paharrueshme poezitë e Hafiz Ali Korçës si: *“Mirë se erdhe han'e uruar”*, *“Njëtimi”*, *“Shpirt i dëshmorit”*, *“Vajtimit e atdheut”*, që ka aktualitet atdhetar e kombëtar, që është botuar e po ribotohet në organe të ndryshme të shtypit në Shqipëri e në trojet shqiptare e në diasporë. Në këtë fushë janë bërë të përmendura poezitë e shumta të Ferit Vokopolës nën titullin përmbledhës *“Fluturimet e shpirtit”* dhe poezi të veçanta si *“Hana e Ramazanit”*, etj.

Pjesës letrare i bashkëngjiten edhe rubrikat *“Botime të reja”*, *“Botime të veçanta”* e *“Bibliografi”*. Gjithë përmbajtja e revistës është një pasuri e çmueshme kulturore, është një traditë e bukur fetaro-atdhetare, është një ndihmesë e vyer në publicistikën shqiptare. Revista u bë boshti kryesor i përhapjes së dijeve dhe i mendimeve islame. Diapazoni i tematikës që ajo trajtoi ka qenë i gjerë. Në të u rrahën çështje doktrinare, të atdhedashurisë, të politikës së kohës, çështje sociale, kulturore, ekonomike etj., etj. Ajo që në numrat e parë e shtroi drejt, nevojën për një kulturë islame me karakteristika e tradita shqiptare me një qëllim të vetëm: *“Që vendi ynë të mos binte në grackën e organizimit të mbrapshtë të shoqërisë moderne e të mos bëhej pre e kësaj shoqërie”* (F. Luli & I. Dizdari (1998): 3-4; A. Basha (2013): 8-13).

Përfundimi

Dalja në dritë e revistës *“Zani i Naltë”* ka qenë një ngjarje e shënuar, një shprehje dhe tregues i qytetërimit. *“Zani i Naltë”* u kthye në një vend takimi, në një derë, në një fushë, në një rrugë që të çonte drejt progresit.

Përmbajtja kryesore ka qenë ajo fetare, duke pasur si bosht komentin e librit të shenjtë Kur'anin, jetën e Profetit Muhamed (a.s.) dhe historinë islame.

Në faqet e revistës ka pasur shkrime me karakter politik, analizues, përgjithësues e shkëmbim përvoja për organizimin e medreseve e për rezultatet e tyre, për zhvillimin e mësimin të besimit në shkollat shtetërore, për rëndësinë e edukimit të gjithanshëm të rinisë në aspektin fetar, atdhetar, moral e kulturor.

“Zani i Naltë” shpreh gjuhën e shpirtit të intelektualëve shqiptar të asaj kohe, të cilët edhe kanë folur, edhe kanë shkruar, por edhe e kanë përjetuar/praktikuar atë.

Literatura e shfrytëzuar

- [1]. Bala, Adem. “Zani i Naltë” – *Revistë e orientimit drejt reformave dhe progresit shoqëror*, në: *Drita Islame*, nr. 23 (154), dhjetor 1998.
- [2]. Basha, Ali. *Tematika e revistës “Zani i Naltë” është bashkëkohore*, në: *Zani i Naltë*, nr. 5, Tiranë, 2013.
- [3]. Faik Luli&Islam Dizdari, *75-vjetori i botimit të revistës “Zani i Naltë”*, në: *Drita Islame*, nr. 23, Tiranë, 1998.
- [4]. Memeti, Beqir. “Zani i Naltë” – *zëvendës i mendimit intelektual shqiptar mysliman*, në: Konferencën shkencore *Zani i Naltë, thesari kulturor, fetar e kombëtar*, Shkup, 25 nëntor 2016 (punim në dorëshkrim), 2-4.
- [5]. Skura, Gentiana. “Zani i Naltë” dhe kontributi për vetëdijësimin kombëtar shqiptar. në: *Zani i Naltë*, v. XV, nr. 1 (154), Tiranë, 2013.
- [6]. *Zanit të Naltë*, vëllimi I, Tiranë, 2013, f. 2-3.